

Këshilli Ekonomiko Social – KES Dhjetor 2012

Këshilli Ekonomik Social – KES, i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Odës Ekonomike mbajti disa takime gjatë muajit dhjetor 2012 ku temë kryesore ishte Kontrata e Përgjithshme Kolektive.

Pas një debati të gjatë të zhvilluar nga antarët e këtij Këshilli, nga Ministria e Punës u kërkua që nënshkrimi i Kontratës Kolektive të shtyhet deri pas amendamentimit të Ligjit të Punës, ndërsa përfaqësuesit e BSPK-së dhe OEK e kundërshtuan këtë kërkesë dhe insistuan që Kontrata e Përgjithshme Kolektive të nënshkruhet sa më parë dhe pastaj të përcillet në procedurat e mëtutjeshme. Pas shqyrtimit të hollësishëm të të gjitha neneve të Kontratës Kolektive dhe pas marrjes parasysh të të gjitha vërejtjeve të bëra nga partnerët social u vendos që Kontrata Kolektive të përcjellet në Minsitrinë e Punës për procedura të mëtutjeshme.

KES diskutoi edhe për Pagën Minimale në Republikën e Kosovës për vitin 2013, ku të tre partnerët social lidhur me këtë qështje kishin mendime të ndara.

Oda Ekonomike e Kosovës mbronte propozimin që paga minimale për vitin 2013 duhet të jetë 190 €.

Ministria e Punës propozoi që paga minimale duhet jetë e kategorizuar në 200 € për të punësuarit mbi 35 vite dhe 160 € për punësuarit më të ri se 35 vite.

Ndërsa BSPK-ja insistoi që paga minimale duhet të jetë 250 €, duke marrë parasysh që as me këtë shumë në asnjë mënyrë nuk mund të përmbushen kërkesat për shportën e një familje katër anëtarëshe në Kosovë. Madje kryetari i BSPK-së Haxhi Arifi si përfaqësues i punëmarrësve tha se pagën minimale prej 250 € e ka kërku edhe për vitin 2012.

Në fund të takimit të gjithë anëtarët e KES-it u dakorduan që paga minimale për vitin 2013 në Republikën e Kosovës duhet të jetë 220 € dhe pa kategorizime.